# FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
# KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

## RENDI I DITËS

FGJK duke u bazuar në statutin e saj, mbajti mbledhjen e Bordit Ekzekutiv (BE) të FGJK, me datë 24/04/2025, ditë e enjte duke filluar nga ora 15:00 në zyrën e FGJK-së në Shtëpinë e Sporteve në Prishtinë.

**REND I DITËS**

1. Hapja e mbledhjes nga Kryetari, - mbledhja u hap nga Kryetari i FGJK-së Z. Shkumbin Maqastena, ku njëherit falenderoj të gjithe pjesëmarrësit për prezencën e tyre.
2. Caktimi i një process-mbajtësi: Proces mbajtës për këtë mbledhje u caktua Z. Amir Tahiraga, Sekretari i Përgjithshëm,
3. Verifikimi i pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre: Të pranishëm në këtë mbledhje ishin
    1. Shkumbin Maqastena – Kryetari i FGJK-së,
    2. Besim Halilaj – Nenkryetarë i FGJK-së,
    3. Sherife Qerimi – Nenkryetare e FGJK-së,
    4. Elfete Gashi – Anëtare e BE të FGJK-së,
    5. Amir Januzi – Anëtarë i BE të FGJK-së,
    6. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK-së,
    7. Ard Kryeziu – Anëtarë i BE të FGJK-së,
    8. Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së, pa të drejtë vote,
    9. Arlind Shaqiri – Sekretar Teknik i FGJK-së, pa të drejtë vote.
    10. Abeliana Bregu – Selektore për gjimnastikë artistike për femra, pa të drejtë vote.

    Në total pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin 7 anëtar me të drejtë vote dhe 3 anëtar pa të drejtë vote, dhe u konstatua se ka kourum për vazhdimin e mbledhjes së BE të FGJK-së.
4. Trajnimi për Trajner (rregullorja), pagesa për trajner: në këtë pikë të rendit të ditës, është diskutuar për trajnim i cili do të organizohet nga FGJK, trajnimi do të përfshinë, edhe ndihmën e parë, dhe se licensa do të jetë valide për dy vjet, çdo pjesëmarrës do të paguaj shumën nga 50 euro në momentin e regjistrimit të tij/saj për pjesëmarrje në këtë trajnim. Trajnerët të cilët e kanë të përfunduar nivelet e FIG Academy, duhet që vetëm të bëjnë pagesën dhe do të pajisen me licensë të lëshuar nga FGJK. Pas shumë diskutimeve të gjithë anëtarët e BE të FGJK-së, unanimisht votuan PËR, nuk kishte kundër apo abstenim.

## RENDI I DITËS

5. Mbushja e gropës në sallën e gjimnastikës, rregullimi i zhveshtoreve, pastrami i sallës vendosja e fotografive të gjimnastëve dhe gjimnasteve në muret e sallës, në Pallat të Sportit: Kryetari i FGJK_së, Z. Shkumbin Maqastena, njoftoj të pranishmit se është duke u bërë përpjekjë për mbushjen e gropës në sallën e gjimnastikës në pallat të rinisë dhe sporteve, dhe se për momentin jemi në negociata me vendorët për çmim për mbushjen e gropës, gjithashtu, njoftojë se me daljen e TM-1, 2025, do të bëhet edhe rregullimi i zhveshtoreve në sallë, vendosja e fotografive të gjimnasteve, ekipit etj, të gjithë të pranishmit ishin të pajtimit më mendimin e Kryetarit.
6. Uniformat e sportistave: Anëtarët e BE e FGJK-së, janë njoftuan se FGJK do blej garderobë sportive për gjimnaste të ekipës së parë, për trajnerë të FGJK-së. Të gjithë anëtarët unanimisht votuan pro këtij propozimi, nuk kishte kundër apo abstenim.
7. Uniformat për staf (organizatorët e garës, gjyqtarët) - Anëtarët e BE e FGJK-së, u njoftuan se FGJK do blej garderobë për Gjyqtarë dhe Staf të FGJK-së. Të gjithë anëtarët unanimisht votuan pro këtij propozimi, nuk kishte kundër apo abstenim.
8. Organizmi i garës për kategorinë B, caktimi i datës dhe vendi: Në këtë pikë të rendit të ditës foli Selektorja Z. Abeliana Bregu, ku thekësoj se është mirë që kësaj rradhe të shkohet me Garën e ligës C, ndërsa më vonë të mbahen garat e Ligës B, gjithashtu është propozuar që gara të mbahet me datë 24/25 Maj 2025, në sallën e gjimnastikës në Pallat të inisë dhe Sporteve, në tri dispilina, dhe se most ë quhet Ligë po të quhet Niveli A, B, C. dhe se kjo garë të quhet gara e nivelit C, dhe është kërkuar nga Sekretari Teknik Z. Arlind Shaqiri që të punoj në rregullimin e kompozimeve obligative (caktim të elementeve) për këtë garë, gjithashtu është propozuar që të ndahen medalje dhe mirënjohje për 8 vendet e para, (medaljet 1,2,3 të dallojnë nga tjerat) të gjithë të pranishmit ishin pro, nuk patë kundër apo abstenim.
9. Rishqyrtimi i rregullorës së transferit të gjimnastëve, (për çdo 6 muaj, në vetëm një herë në vit), Kryetari i FGJK-së, Shkumbin Maqastena, theksoj që bëhet përditësimi i kësaj rregullore pasi që kjo rregullore në vetë përmban dy afate kalimtare kur gjimnastet mund të kalojnë nga një klub në tjetrin. Në këtë pikë Sekretari i FGJK-së, Amir Tahiraga, theksoi, që rregullorja mund të përditësohet dhe se kalimi i gjimansteve nga nje klub ne tjetrin të bëhet vetëm njëherë në vit, anëtarët e BE të FGJK-së, theksuan nevojën që të vendoset edhe një nen ku obligon klubin ku

gjimnastja dëshironë të kaloj që të bëhet me marrveshje të klubeve, Sekrtari njoftoj të pranishmit se një gjë e tillë është e cekur në rregullore, dhe se pa pajtim me shkrim të dy klubeve, asnjë gjimnaste nuk mund të kaloj apo transferohet ne klube tjetër, gjithashtu ata theksuan që të vendoset edhe neni ku obligon klubin marrës që të paguaj shumë monetare varësisht nga kërkesa e klubit, edhe për këtë pikë të gjithë anëtarët e BE të FGJK-së, votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.

10. Pagesa për pjesëmarrje në gara: Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, theksoj që është e nevojshme që gjimnastet dhe gjimnastët të paguajnë një shumë simbolike për regjistrim në gara të FGJK-së, praktikë që ka qenë edhe më herët mirëpo është ndal, dhe se tash është koha për të vazhduar prap me të njejtën praktik, dhe pas diskutimeve është marr vendim që gjimnastet/gjimnastët të paguajnë regjistrimin e tyre për secilën garë që marrin pjesë nga 5 euro, përveç ekipit përfaqësues të FGJK-së, të gjithë të pranishmit votuan pro nuk patë kundër apo abstenim
11. Pjesëmarrja në kampin e EG në Finland, caktimi i trajnerëve dhe gjimnasteve: për këtë pikë Z. Abeliana Bregu se bazu në rezultate e gjimnasteve në këtë kamp të organizuar nga Gjimnastika Europiane, do marrin pjesë, Fernaze Cakaj, Hira Haziri, dhe Djellona Azemi, dhe trajnerët e propozuara janë, Doruntinë Ibrahimi dhe Sherife Qerimi, në këtë pikë Sekretari i FGJK-së, Z. Tahiraga njoftoj, bazu në kërkesat e EG, vetëm 3 gjimnaste dhe 2 trajnere mund të regjistrohen mirëpo një kërkesë nga Sekretari do i dërgohet organizatorëve për të mundësuar regjistrimin e trajnerës së tretë e që do të jetë Z. Abeliana Bregu. Të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
12. Pjesëmarrja e ekipit në EYOF, në Salamunov memorial, kampe etj: BE e FGJK-së, janë njoftuar se për pjesëmarrje në këtë event, fillimisht KOK ka dërguar që FGJK të bëjë regjistrimin e një gjimnaste dhe një trajnerë, mirëpo me kërkesë të Sekretarit dhe spjegimit që FGJK do marr pjesë si ekip është bërë e mundur që FGJK të regjistroj tri gjimnaste dhe dy trajnere për gjimnastikë artistike për femra, garë që do mbahet në Osjek të Kroacisë.
13. Raportimi pranë bordit për kampin në Osjek, Emrat e gjimnasteve dhe trajnereve janë: Trajnere: Abeliana Bregu, Doruntinë Ibrahimi, Gjimnaste: Sara Pllana, Rea Berisha dhe Bora Hoti.

Gjithashtu në këtë pikë Z. Abeliana Bregu, njoftoj BE të FGJK-së, se përvec EYOF do këtë garë edhe në Salamunov Memorial në Maribor të Sllovenise, dhe pjesëmarrja në garën e organizuar nga Confsport Italia, dhe pasiqë FGJK ka memorandum të bashkëpunimit me Confsport Itali, këta të fundit do ti mbulojnë shpenzimet e akomodimit, të ushqimit, dhe regjistrimit të 5 gjimnasteve dhe 2 trajnerëve, dhe se FGJK ka kërkuar nga organizatori që të shtohet numri i gjimnasteve dhe trajnerëve në këtë garë, kurse shpenzimet do i merr FGJK, për numrin e shtuar. Për këtë u propozua që gjimnastet e nivelit B të marrin pjesë në këtë event, dhe se një garë kontrollluese do të mbahet me datë 30/04/2025 dhe 01 Maj 2025, në Sallën e Gjimnastikës në Pallat të Rinisë dhe Sporteve, dhe në sallën në Fakultet të Edukimit Fizik dhe Sporteve, pas rezultateve do të garës, do të përpilohet lista finale me emra të gjimnasteve që do marrin pjesë në garë në Itali. Anëtar i BE të FGJK-së, Z. Ard Kryeziu propozoj që FGJK të organizoj edhe një garë me studentat të FEFS, ku nga ajo garë do mund të nxjerrim edhe trajner të ri.

14. Raportimi për vizitën e Kryetarit të Gjimnastikës Ballkanike, Z. Suat Celen në Kosovë: Kryetari Z. Shkumbin Maqastena dhe Sekretari i FGJK-së, Z. Amir Tahiraga njoftuan të pranishmit për vizitën e Kryetarit të Federatës së Gjimnastikës Ballkanike, njëherit edhe Kryetari i Federatës së Gjimnastikës se Turqisë, në Kosovë, Z. Suad Celen, takimet zyrtare me KOK, dhe se parapërgatitjes së një memorandum bashkëpunimi ndërmjet FGJK-së, dhe Federatës Turke, gjithashtu FGJK është njoftuar që shteti Turk ka arritur që të bëjë prodhimin e të gjitha veglave gjimnastikore, dhe se pritet që këto vegla të çertifikohen nga FIG, dhe se është dhënë premtimi që FGJK-ja të ndihmohet si në aspketin e trajnimit, kampeve, gjyqtarisë, dhe veglave.
15. Të ndryshme – nuk kishte.

Mbledhja e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së përfundoj në ora 17:30.

Sekretar i Pëgjithshëm i FGJK-së
**Amir Tahiraga**